



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 24.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **23.05.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.SH. LABELA TEAM – z. Labinot Hasani, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Kontraktimi i eksperteve për Njësinë Koordinuese të projektit të Bankës Botërore” Lot 5** me Nr. të Prok: **206-24-3303-2-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik N.T.SH. LABELA TEAM – z. Labinot Hasani, e dt. 23.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Kontraktimi i eksperteve për Njësinë Koordinuese të projektit të Bankës Botërore” Lot 5** me Nr. të Prok: **206-24-3303-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 22.05.2024.
2. **Mbetet në fuqi**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 22.05.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.SH. LABELA TEAM – z. Labinot Hasani, me datën 23.05.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Kontraktimi i eksperteve për Njësinë Koordinuese të projektit të Bankës Botërore” Lot 5** me Nr. të Prok: **206-24-3303-2-2-1**. AK-MSh, me datë 23.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Nuk ka të specifikuar.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Të nderuar,
bazuar në njoftimin tuaj të dt. 22.05.2024 përmes Letrën Standarde me anë të cilës keni marr Vendim të më Eliminoni nga gara konkurruese, me arsyetimin se unë kam aplikuar në cilësi të Kompanisë, luteni

të ktheni lëndën në Rivlerësim dhe të shqyrtoni aplikacionin tim edhe njëherë, për arsye se; unë kam dy llogari aktive në portalin E-Prokurimi, dhe atë;

1. I regjistruar si Zyrtar i Autoritetit Kontraktuar, me qenë se jam i punësuar i rregulltë në IKSHPK - Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Zyrtar Shtetëror. Në portalin E-Prokurimi, sistemi nuk më ka dhënë mundësin të aplikoj, edhe përkundër faktit që unë e kam tërheq Dosjen e Tenderit, dhe

2. I regjistruar si Kompani lokale emërtuar; Labinot Hasani B.I., me qenë se jam pronar 100 %, atëherë e kam shfrytëzuar rastin të tërheq Dosjen e Tenderit, të pregatis dokumentacionin në emër timin personal pa e ndërlidh me emrin e kompanisë, ndërsa e kam shfrytëzuar llogarinë vetëm për dorëzim të aplikacionit.

I gjithë dokumentacioni në aplikimin tim është i plotësuar me emrin tim personal, ndërsa askund në aplikacion nuk figuron emri i kompanisë, me përjashtim në raportin përfundimtar të gjeneruar për lidhje të ofertës nga vet portali në mënyrë automatike.

Numri Fiskal i kompanisë time „Labinot Hasani B.I.“ në Ministrinë e Tregëtisë është 810935140, përmes të cilës i paguajmë kontributet shtetërore në Administratës Tatimore të Kosovës. Nërsa, Nr. Fiskal si person Fizik i regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës është po i njëjti 810935140.

Kontributet Shtetërore nga të ardhurat e kompanisë dhe të ardhurat si person fizik regjistrohen në emër timin që unë përfaqësoj edhe veten time e edhe kompanin e regjistruar në emër timin, që të dyja përmbajnë numrin e njëjt Fiskal.

Për më tepër unë nuk kam dorëzuar dokumente apo çertifikatë të biznesit, e as në Deklaratën nën Betim të DT-së dhe askund tetër nuk përfshihet emri i kompanisë, por është vendos Emri im personal me nr. të letërnjoftimit.

Prandaj, pasi që e kam shfrytëzuar llogarinë e kompanisë në portalin E-Prokurimi vetëm për të dorëzuar dokumentacionin për Lot V, Specialist i TI-së, luteni të vlerësoni edhe njëherë aplikimin tim për këtë pozitë.

Nëse ju nevojitet ndonjë informatë shtesë, me kënaqësi do të ju përgjigjem.

Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore


E kemi shqyrtuar me shume kujdese kerkesen tuaj per rishqyrtim dhe jemi munduar qe te shikojme mundesine per pranimin e sajë dhe kualifikimin tuaj, por nuk te pranohet oferta juaj pasi qe ne sistem e keni plotësuar Formularin e tenderit si N.T.SH. LABELA TEAM dhe ne kete faze te procedures kjo nuk eshte e mundur te korrigojohet si Labinot Hasani. Teknikisht nuk na mundesohet te procedojme tutje dhe te lidhim kontrate me emertimin N.T.SH. LABELA TEAM pasi qe i gjithe aktiviteti dhe specifikimi teknik i Aneksit 1 te Dosjes se tenderit ka qene per • Specialist i IT-se, e jo per kompani.

Edhe pse dokumentacionin percjelles te ofertes ju e keni plotësuar si individ, por Formularin e tenderit ne sistem e keni plotësuar si N.T.SH. LABELA TEAM dhe ne çdo hap te metutjeshem sistemi kete oferte e njeh si N.T.SH. LABELA TEAM, andaj pretendimet e juaja ankimore i konsiderojme te pa bazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit